




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
~~Qeveria -Vlada-Government~~



Republika e Kosovës
Komuna e Gjakovës
Ministria e Shëndetësisë
Ministry of Health
Ministarstva Zdravstva/
Ministry of Health
Drejtoria për Punë të Përgjithshme Administrative
Uprava za Opšte, Administrativne Poslove
01
Nr./Br. 413101-21477
Data/Datum 24. 09 2020
Gjakovë-Djakovica-Gjakova

**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
NDËRMJET
MINISTRISË SË SHËNDETËSISË
DHE
KOMUNËS SË GJAKOVËS**

**PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT “Ndërtimi i objektit të Qendrës Kryesore të
Mjekësisë Familjare në Gjakovë”**

Palët Nënshkruese

1. Ministria e Shëndetësisë, e përfaqësuar nga Ministëri, z.Armend Zemaj, Rruga e Zagrebit nr.60, Prishtinë dhe
2. Komuna e Gjakovës e përfaqësuar nga Kryetari Komunës, z.Ardian Gjini, Rruga Nënë Tereze, Gjakovë

**Neni 1
Qëllimi**

1. Qëllimi i kësaj Marrëveshje të Bashkëpunimit është përcaktimi i obligimeve të përbashkëta institucionale duke përfshirë mbështetje financiare të cilat palët do t'i përmbushin në funksion të realizimit (përfundimit) të projektit “Ndërtimi i objektit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare” në Gjakovë.
2. Realizimi i projektit për ndërtimin e objektit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Gjakovë i konceptuar duke u bazuar në nevojat dhe kërkesat e qytetarëve të Komunës, është në përputhje me politikat e Ministrisë së Shëndetësisë për zhvillimin dhe përmësimin e infrastrukturës së kujdesit shëndetësor në njërin anë, si dhe në funksion të ushtrimit të suksesshëm të përgjegjëgjësive të Komunës së Gjakovës të përcaktuara me

2. KOMUNËS E GJAKOVËS

- 2.1 Obligohet t'i krijoj kushtet e nevojshme për realizimin e projektit "Ndërtimi i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Gjakovë" për operatorin ekonomik, të ndërmerr te gjitha masat që kontraktuesi, pa pengesa të fillon në implementimin e projektit me kohë.
- 2.2 Emëron (ose) angazhon staf nga resurset profesionale (ose) kompani profesionale mbikëqyerse, në harmoni me Ligjin e Ndërtimit, Mbikëqyrsi (t) profesional mban përgjegjësi të plote për sasisë dhe cilësitë e materialeve dhe punimeve të realizuara.
- 2.3 Mbikëqyrsi bashkëpunon me menaxherin e kontratës të emëruar nga Ministria e Shëndetësisë (sipas kushteve për emërimin dhe kushteve tjera të kontratës).
- 2.4 Mbikëqyrsi (t) profesional me përgjegjësi të plotë njofton menaxherin e projektit vazhdimisht për ecurinë e implementimit të projektit, përmes raporteve javore dhe shkresave (sipas nevojës), në formë të kopjes së fortë ose elektronike.
- 2.5 Mbikëqyrsi (t) e punimeve, obligohet që të njoftoj Ministrinë e Shëndetësisë për çdo propozim ndryshim eventual të sasisë dhe kualitetit gjatë implementimit të projektit, dhe për këtë të kërkoj pëlqimin e MSH-së.
- 2.6 Komuna është e obliguar të njoftoj Ministrinë e Shëndetësisë për rrjedhat e realizimit të projektit.

Neni 4 Pronësia e projektit

1. Me pranim dorëzimin e punëve të kryera nga ana e operatorit ekonomik, ky investim (projekt) nga kjo Marrëveshje e Mirëkuptimit do kaloj në pronësi të Komunës të Gjakovës.
2. Ky investim regjistrohet në pronësi të komunës në mënyrë elektronike dhe fizike, në sistemin e pasurisë në Ministrinë e Financave (SMIFK).

Neni 5

Ndryshimet dhe ndërprerja e Marrëveshjes së Mirëkuptimit

1. Afati i realizimit të projektit sipas kësaj Marrëveshje duhet të arrihet jo më larg se viti 2020. Pas këtij afati Ministria e Shëndetësisë nuk merr përsiper shpenzimet për realizimin e këtij projekti.
2. Me pëlqimin paraprak të Ministrit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Kryetarit të Komunës marrëveshja mund të ndryshohet dhe plotësohet.
3. Ministria e Shëndetësisë mbanë të drejtën e ndërprerjes së shfrytëzimit të buxhetit për këtë destinim në rast se konstaton se Komuna nuk i përmbushin obligimet e veta të dala nga kjo Marrëveshje.

Neni 6 **Zgjidhja e mosmarrëveshjes**

Palët janë pajtuar që mosmarrëveshjet të zgjidhen me mirëkuptim mirëpo nëse nuk mund të arrijnë mirëkuptim, atëherë në rast të mosmarrëveshjes, kompetente për zgjidhjen e saj është Gjykata Themelore në Prishtinë që ka kompetencë të zgjidhë raste të tilla.

Neni 7 **Nënshkrimi i Marrëveshjes**

Marrëveshja e Mirëkuptimit është nënshkruar në katër (4) kopje të njejta origjinale, nga dy (2) kopje për palët nënshkruese.


Neni 8 **Hyrja në fuqi**

Palët nënshkruese janë pajtuar që kjo marrëveshje e mirëkuptimit të fillon të zbatohet nga dita e nënshkrimit.

Marrëveshja e Mirëkuptimit është nënshkruar në katër kopje, nga dy kopje për secilën palë nënshkruese.

Armend Zemaj

Ministër i Shëndetësisë



Ardian Gjini

Kryetar i Komunës së Gjakovës



Nënshkruar ____/____/____

Prishtinë